



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA



Projekti fitues me titull:

**“Hartëzimi i kompetencave kyçe dhe rezultateve të të nxënimit në dy programe të mësuesisë, me fokus formimin e kompetencave profesionale të studentëve të mësuesisë të Universitetit të Tiranës”
(HK-RN-SUT)**

**financuar nga Universiteti i Tiranës
në kuadër të Programit “UT-Kërkim, Ekselencë dhe Inovacion”
2023**



EKIPI I PROJEKTIT:

Prof. Dr. Esmeralda Kromidha (Udhëheqëse e projektit) – FGJH,UT

Prof. Dr. Andromaqi Haloçi – FGJH,UT

Prof. Asoc. Dr. Leticja Gusho – FSHS,UT

Prof. Asoc. Dr. Çlirim Duro – UT

Dr. Blerina Hamzallari – FSHS,UT

Msc. Sema Hysa – FGJH,UT

Msc. PhDc. Enkelejda Bara – UT

PERIUDHA E ZBATIMIT TË PROJEKTIT:

Maj 2023 – Maj 2024




Përkufizimi i qasjes në bazë kompetencash

Qasja në bazë kompetencash përcakton një model arsimor që rinovon dhe përmirëson formimin në arsimin e lartë bazuar në një logjikë aftësish.

Sipas kësaj qasjeje studenti arrin t'i përvetësojë njohuritë njësoj si në programin e krijuar me objektiva por duke zhvilluar në të njëjtën kohë aftësitë e pritshme për të vijuar studimet apo për të thjeshtuar integrimin në tregun e punës.



PËRFITIMET E STUDENTËVE





1- Qëllimet e programit:

Çfarë aftësish fiton studenti në fund të formimit të tij?



3- Përshtatja e aktiviteteve
pedagogjike:
Zhvillimi i kompetencave

2 – Përshtatja e vlerësimit:
Si do e vërejmë që studenti i ka zhvilluar këto
kompetenca?



Objektivat

⊕ Punësimi afatgjatë i studentëve

⊕ Diploma atraktive

**Programet në bazë
kompetencash**

⊕ Zhvillimi i programeve

⊕ Cilësia pedagogjike e
formimeve



Rezultatet

- ▶ Analiza e programeve mësimore (syllabuseve) të mësuesisë
- ▶ Syllabuse të hartuara me objektiva dhe herë pas here me rezultate të të nxënit të cilat nuk përputhen domosdoshmërisht me vlerësimin e studentit
- ▶ Syllabuset nuk kanë njëtrajtshmëri midis objektivave, rezultateve të të nxënit dhe detyrave
- ▶ Riorganizimi i rubrikës «Rezultatet e të nxënit»
- ▶ Hartimi i syllabuseve në bazë kompetencash të cilat lidhen dhe me vlerësimin e studentit
- ▶ Rishikimi i temave dhe nëntemave
- ▶ Integrimi i detyrave praktike